

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.05/2017	Data: 31.01.2017	

Kuvendi i Komunës së Istogut, në pajtim me nenin 34.2. të Statutit të Komunës, 01Nr.55/14 dhe nenit 10 paragrafi 4 të Rregullore për Punën e Kuvendit të Komunës së Istogut (Rregullorja Komunale Nr. 3/2014) në mbledhjen e mbajtur me 31.01.2017, shqyrtoi Projekt-Rregulloren Komunale për Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat dhe mori këtë:

V E N D I M

01-039-1 Data 06.02.2017
Kf. Datum

- I. Hapet diskutimi publik për Projekt-rregulloren Komunale për Taksat, Ngarkesat dhe Gjobat.
- II. Diskutimi publik për projekt-rregulloret e cekura më lartë, do të jetë i hapur prej 01.02.2017 deri më 14.02.2017.
- III. Projekt-rregullorja është e ekspozuara në Sallën e Kuvendit të Komunës, në Istog, për çdo ditë pune prej orës 08⁰⁰ deri në orën 16⁰⁰.
- IV. Inkurajohen dhe ftohen të gjithë qytetarët, personat juridik dhe shoqatat civile në territorin e Komunës së Istogut, që t'i parashtrojnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në këtë projekt-rregullore brenda kohës dhe afatit të përcaktuar në pikën II. të këtij Vendimi.
- V. Për çdo informatë të interesuarit mund t'i drejtoheni Asistentes së KK-së, zyra nr. 305, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.
- VI. Ky Vendim të shpallet: në tabelën e shpalljeve, ne mjetet e informimit elektronik dhe ne Ueb faqen e Komunës së Istogut, me qëllim të njoftimit të qytetarëve të Komunës së Istogut.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.



Kryesuesi,
Hazbi Bajra